



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME

Numri i lëndës: 2020:009666

Datë: 27.01.2025

Numri i dokumentit: 06761811

ARJ.nr.250/2024

GJYKATA SUPREME NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët, Ragip Namani, kryetar, Beshir Islami dhe Milena Djerić, anëtar, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale Zanë Buçinca, procesmbajtëse, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditëses M(A) Sh., nga P., të cilën e përfaqëson me autorizim, Hamdi Podvorica, avokat në Prishtinë, kundër të paditurës, Ministria e Shëndetësisë e Republikës së Kosovës-Inspektorati Shëndetësor, me seli në P., me bazë juridike anulimin e aktit administrativ - vendimit të paditurës me nr.10/K-59-19 të datës 30.12.2019, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor të paditëses, të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit-Departamenti për Çështje Administrative, AA.nr.999/2023, të datës 16.10.2024, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 22 Janar 2025, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet e pabazuar kërkesa për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor, e parashtruar nga paditësja, M(A) Sh., kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit- Departamenti për Çështje Administrative, AA.nr.999/2023, të datës 16.10.2024.

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e Gjykatës së Apelit në Prishtinë, AA.nr.999/2023, të datës 16.10.2024, është vendosur si në vijim: Refuzohet si e pa bazuar ankesa e paditëses, M (A) Sh., nga P., ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, A.nr.188/20, i datës 25.10.2023, vërtetohet.

Kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit, paditësja, përmes të autorizuarit të saj, në afat ligjor në këtë gjykatë ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor, me të cilën e konteston ligjshmërinë e të njëjtit, për shkak të shkeljes së dispozitave të procedrës administrative, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale me propozim, të; APROVOHET në tërësi si e bazuar kërkesa për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor, të aprovohet padia dhe kërkesë padia e paditëses si e bazuar, ose të ANULOHEN aktgjykimi i Gjykatës së Apelit-Departamenti për Çështje Administrative, AA.nr.999/2023, të datës 16.10.2024, dhe aktgjykimi i Gjykatës Themelore në

Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, A.nr.188/20, të datës 25.10.2023, dhe çështja të kthehet në gjykatën e shkallës së parë, në rigjykim dhe rivendosje.

Përgjigje në kërkesën për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit nuk ka ushtruar pala e paditur.

Gjykata Supreme e Kosovës, në bazë të nenit 53 të Ligjit për Konfliktet Administrative, ka mbajtur seancën e kolegjit dhe pas vlerësimit të aktgjykimit të kontestuar, kërkesës së paditëses dhe shqyrtimit të akteve tjera të lëndës gjen se;

Kërkesa për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se me vendimin e të paditurës Ministria e Shëndetësisë e Republikës-Inspektorati Shëndetësor të Kosovës, nr. 10/K-59-19 (nr.prot.05-7561) të datës 31.12.2019, është refuzuar ankesa e ankueses, ndërsa mbetet në fuqi vendimi i Inspektoratit Shëndetësor me Nr..... (nr.prot.....) i datës 22.11.2019, sipas të cilit paditëses i ndalohej ushtrimi veprimtarisë profesionale në afatin kohor prej një viti.

Kundër vendimit të lartcekur të paditurës MSH, paditësja me padi fillon konflikt administrativ.

Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, me aktgjykimin A.nr.188/20, të datës 25.10.2023, ka vendosur si në vijim: I. REFUZOHET si e pabazuar kërkesëpadi e paditëses, M (A) Sh., nga P., me të cilën ka kërkuar që të anulohet vendimi i të paditurës, Ministria e Shëndetësisë e Republikës së Kosovës Nr..... ,të datës 30.12.2019. II. Secila palë i bart shpenzimet e veta procedurale.

Në arsyetimin e aktgjykimit të saj, gjykata e shkallës së parë ndër të tjera arsyeton se: Për të vlerësuar padinë e paditëses gjykata fillimisht ju referua Ligjit Nr. 04/L-125 për Shëndetësi, konkretisht nenit 71 par. 2 dhe 4 të këtij ligji, i cili përcakton se: “2. *Licencimi i profesionistit shëndetësor bëhet nga Oda përkatëse e profesionistëve shëndetësorë, në pajtim me këtë ligj.* 4. *Profesionisti shëndetësor mund të ofrojë shërbime shëndetësore në mënyrë të pavarur vetëm pas marrjes së licencës.*” Në bazë të shkresave të lëndës, gjykata vërteton se paditësja ka ushtruar veprimtarinë e saj me licencë të skaduar. Paditësja në padi ka deklaruar se ka aplikuar për rilicencim pranë institucioneve relevante mirëpo që e njëjta nuk ka ofruar prova për të vërtetuar këtë. Në bazë të autorizimeve ligjore, për ushtrimin e veprimtarisë mjekësore, licencimi dhe rilicencimi i mjekut është detyrim, ndërsa licenca e punës është dokument publik i cili vërteton përmbushjen e kushteve nga ana e mjekut. Neni 5 i Kodit të Etikës dhe Deontologjisë Mjekësore, përcakton se: “*Mjeku i cili ofron shërbime shëndetësore duhet të jetë: anëtar i OMK-së, i licencuar, të posedojë dhe përdorë vetëm faksimilen e lëshuar nga organi kompetent i OMK-së, të respektojë standardet profesionale gjatë ushtrimit të profesionit, të lëshojë dokumente shëndetësore të nënshkruara dhe të vulosura me faksimil dhe të respektojë vendimet e organeve të OMK-së*”.

Në këtë kuptim dhe në bazë të dispozitave ligjore në fuqi, gjykata vërteton se paditësja ka bërë shkelje kur ka bërë ushtrimin e veprimtarisë me licencë të skaduar. Për më tepër, në bazë të provave në shkresat e lëndës, konkretisht Procesverbalit mbi Inspektimin, nr.000528 të datës 09.09.2019, është vërtetuar se në Spitalin Special për Gjinekologji dhe Obstetrikë “D F” në P, janë gjetur parregullsi gjatë ushtrimit të veprimtarisë së këtij institucioni në të cilën paditësja ka ushtruar profesionin e saj si profesioniste shëndetësore. Udhëzimi Administrativ Nr.06/2013 për Frytnimin e Asistuar Mjekësor, ka përcaktuar procedurat e mbajtjes së regjistrave si dhe dokumentacionit mjekësor të nevojshëm për pacientët në këtë procedurë, ndërsa nga raporti i lartcekur rezulton se nuk janë përfillur procedurat e përcaktuara me këto dispozita. Andaj, duke u bazuar në të lartcekurat gjykata vlerëson se arsyetimi i vendimit të të paditurës të goditur me padi, është i drejtë dhe i bazuar në ligj sepse i njëjti është marrë pas vërtetimit të të gjitha fakteve relevante dhe është bazuar në dispozitat ligjore në fuqi.

Në vazhdim ka theksuar se, gjykata shqyrtoi edhe pretendimet e paditëses mirëpo të njëjtat i vlerësoi pa ndikim në vendosjen ndryshe të kësaj çështje pasi që paditësja ka ushtruar veprimtarinë shëndetësore me licencë të skaduar. Andaj, në bazë të provave të administruara në procedurë si dhe dispozitave ligjore, gjykata vlerëson se në këtë çështje administrative nga ana e të paditurës drejtë është vërtetuar gjendja faktike dhe se në pikëpamje të fakteve të vërtetuara nuk ekzistojnë kontradikta në akte, gjë që në pikat esenciale janë vërtetuar plotësisht e që nga faktet e vërtetuara është nxjerrë vendim i drejtë në pikëpamje të gjendjes faktike. Mbi këto arsye thënie e paditëses në padi nuk i aprovoi, sepse i vlerësoi pa ndikim në vërtetimin e një gjendje tjetër faktike, nga ajo e vërtetuar nga e paditura. Andaj në kuptim të nenit 43, 46, paragrafit 2, lidhur me nenin 5, 6 dhe 38 të LKA-së, gjykata e shkallës së parë vendosi si në dispozitiv të aktgjykimit të saj.

Gjykata e Apelit në Prishtinë, me aktgjykimin e kontestuar me kërkesë, duke vendosur sipas ankesës së palës paditëse në kuptim të nenit 49 dhe 63 të LKA-së dhe nenit 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore LPK-së, vendosi si në dispozitiv të aktgjykimit të saj si më lartë. Në arsyetim pasi bën përshkrimin e gjendjes faktike të vërtetuar nga gjykata e shkallës së parë, bazuar në shkaqet dhe arsyet po ashtu të njëjta, qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë e pranon në tërësi si të drejtë dhe ligjor, duke vlerësuar se gjendja faktike është vërtetuar në mënyrë të plotë dhe të drejtë dhe drejtë është aplikuar e drejta materiale me refuzimin e kërkesëpadisë së paditëses. Kolegji i apelit vlerëson se janë të pa bazuara pretendimet ankimore për vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, pasi që pala paditëse me asnjë provë nuk i ka vërtetuar pretendimet e saj ankimore, ndërsa provat e propozuara si prova të bashkangjitura me shkresat e lëndës nuk janë me ndikim për vendosje ndryshe të kësaj çështje administrative juridike. Andaj, konstatoi se aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë, është vendim i drejtë dhe i ligjshëm dhe në kuptim të dispozitave nga neni 49 të LKA-së, lidhur me nenin 200 të LPK-së, të aplikueshëm sipas nenit 63 të LKA-së, vendosi si në dispozitiv të aktgjykimit të saj.

Gjykata Supreme e Kosovës, me rastin e shqyrtimit të kërkesës për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor, gjen se gjykata e shkallës së dytë ka vendosur drejtë kur ka refuzuar si të pabazuar ankesën e paditëses dhe ka vërtetuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës

së parë, me të cilin është refuzuar kërkesëpadia e paditëses si e pabazuar. Qëndrimin juridik të gjykatave të instancës më të ulët, si të rregullt dhe të bazuar në ligj në tërësi e aprovon edhe kjo gjykatë, ngase aktgjykimet e goditura nuk janë përfshirë me shkelje të së drejtës materiale, siç pretendon paditësja në kërkesë.

Pretendimet e paditëses të theksuara si në kërkesën për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor, se gjykata e shkallës së parë dhe e dytë kanë bërë shkelje të dispozitave materiale, neni 85 i LPPA-së, se e njëjta nuk ka shkelur nenet 11.1, 1.2, 1.3 dhe 1.4, të U.A nr. 06/2013, se masa e shqiptuar mund të shqiptohet vetëm për gabimet e rënda profesionale, ndërsa fajësia për mos vazhdimin me kohë të licencës i atribuohet organeve të autorizuara shtetërore, kolegji i shqyrtoi në tërësi në baza ligjore dhe vlerëson se nuk janë të bazuara dhe të qëndrueshme. Nga shkresat e lëndës shihet se paditësja ka ushtruar veprimtarinë e saj me licencë të skaduar, ndërsa para gjykatës nuk ka ofruar prova se ka aplikuar për ri-licencim, duke vepruar në kundërshtim me dispozitat ligjore nga neni 71, par.2 dhe 4, të Ligjit Nr. 04/L-125 për Shëndetësi, si dhe neni 5 të Kodit të Etikës dhe Deontologjisë Mjekësore.

Gjykata nuk shqyrtoi pretendimet e tjera të parashtrueses të kërkesës, lidhur me konstatimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, duke pasur parasysh se, sipas dispozitës së nenit 24 paragraf 2 të LKA-së, përcaktohet se: *“Kërkesa për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit mund të parashtrohet vetëm për shkak të shkeljes të drejtës materiale ose të shkeljeve të dispozitave të procedurës, që do të mund të kishte ndikim në zgjidhjen e çështjes”*.

Nga theksimet si më lartë, Gjykata Supreme konstaton se pretendimet e paditëses janë të pabazuara dhe jo të qëndrueshme, për deri sa aktgjykimi i gjykatës së shkallës së dytë është i qartë dhe i kuptueshëm, në arsyetim përmban arsye të mjaftueshme në baza ligjore nga rezulton se janë vlerësuar të gjitha faktet vendimtare sipas mënyrës së vendosjes në këtë çështje juridike administrative, e po ashtu e drejta materiale është zbatuar drejt dhe nuk është shkelur ligji në dëm të paditëses.

Nga të lartcekurat, e në bazë të nenit 54 par.1, të Ligjit për Konfliktet Administrative, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME - PRISHTINË
ARJ.nr.250/2024, me datë 22 Janar 2025

B. Profesionale,
Zanë Buçinca

Kryetari i kolegjit,
Ragip Namani